



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

01 Nr. 412/26 Dt. 04.09.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 paragrafi f dhe g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, të Memorandunit të Mirëkuptimit 01 nr. 384/26, të datës 10.08.2026 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Lejohen mjetet financiare për realizimin e projektit që ka të bëj me mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të Strehimores për një periudhë fillestare prej katër (4) viteve: 2026, 2027, 2028, 2029 i cili projekt është i bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit, Komunës së Suharekës, Komunës së Dragashit, Komunës së Mamushës dhe OJQ “Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve” 01 nr. 384/26, të datës 10.08.2026. Kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, për vitin 2026, në emër të realizimit të këtij projekti dhe konform pikës 3 të Memorandunit të Mirëkuptimit të lartcekur, lejohen mjetet financiare në shumë prej 8000 € (tetë mijë euro).
2. Zyrtar përgjegjës për mbikëqyrje projektit, nga Komuna e Prizrenit caktohet Bashkim Rakaj.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Mirëkuptimit 01 nr. 384, të datës 10.08.2026.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
5. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - OJQ “QSGF”,
 - Arkivës së Kryetarit.

